



KONFERENCA STUDENTORE: “SFIDAT E BIZNESIT NË EPOKËN DIGJITALE”

09 qershor 2021 | ONLINE

DATA TË RËNDËSISHME

- ✓ Afati i fundit për dorëzimin e abstrakteve: **18 maj 2021**
- ✓ Njoftimi vetëm për pranimin e abstrakteve: **20 maj 2021**
- ✓ Afati për dorëshkrimet e plota: **30 maj 2021**
- ✓ Njoftimi për pranimin e punimit: **04 qershor 2021**
- ✓ Drafti i programit: **06 qershor 2021**
- ✓ Data e konferencës: **09 qershor 2021**
- ✓ Gjuha e konferencës: **Shqip dhe anglisht**
- Dërgoni abstraktin tuaj në adresën: **konferencastudentore@unkorce.edu.al**

Në bashkëpunim me:

KONFERENCA STUDENTORE:

SFIDAT E BIZNESIT NË EPOKËN DIGJITALE

09 qershor 2021 | ONLINE



THIRRJE E HAPUR PËR KUMTESA

PARAQITJE

Zhvillimet e fundit të teknologjive të informacionit kanë krijuar një mjedis shumë të favorshëm për bizneset për të përshtatur ofertën në treg dhe për të plotësuar sa më mirë nevojat e konsumatorëve. Mjedisi modern i biznesit inkurajon bizneset të rriten në mënyrë eksponenciale jo vetëm në tregjet lokale por edhe ato ndërkombëtare. Pavarësisht këtyre bizneset cdo ditë përballen me probleme potenciale të cilat duhet të menaxhohen me efektivitet.

1. Rezistenca për ndryshim. Studimet kanë treguar se rezistenca për ndryshim është një nga faktorët ndikues në shkallën e penetrimit të teknologjive inovative.
2. Menaxhimi i një sasive shumë të madhe informacioni. Teknologjitë moderne mundësojnë personalizimin e komunikimit me konsumatorët por nga ana tjetër kjo rrit sasinë e informacionit që duhet të përpunohet. Sfida e biznesit qëndron në mundësitë e regjistrimit dhe përpunimit të të dhënave në kohë reale.
3. Fokusi tek kënaqësia e nevojave konsumatore. Në ditët e sotme konsumatorët e kanë më të lehtë të gjejnë se çfarë kërkojnë. Ata mund të përdorin telefonin, kompjuterin personal ose tabletin për të kërkuar informacion, për të bërë blerje ose për të patur akses në faqe të ndryshme elektronike. Kompanitë duhet ti shfrytëzojnë këto mundësi.
4. Matja e rezultateve. Shpeshherë kompanitë mbledhin sasi të mëdha informacioni dhe nuk matin treguesit e duhur të performancës. Zgjidhja është përdorimi i teknologjive të inteligjencës artificiale për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave dhe matjen e rezultateve.
5. Investimi në kapitalin human. Sfida me të cilën përballen bizneset sot është dhe investimi në infrastrukturë. Kjo nuk do të thotë zëvendësimi i paisjeve fizike por gjetja dhe investimi në kapitalin human për të transformuar kompanitë nga pikëpamja digjitale.

Celësi i suksesit në mjedisin modern të biznesit është përdorimi i teknologjive të duhuara për të siguruar vlerën më të madhe. Fatmirësisht teknologjia egziston për ti ndihmuar bizneset sot.



QËLLIMI I KONFERENCËS

Kjo konferencë u iniciua nga Fakulteti i Ekonomisë të Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë dhe Institutit të Edukimit Trashëgimisë dhe Turizmit, IETT, Tiranë. Qëllimi i konferencës është të sigurojë një forum për studentët për të prezantuar punime teknike. Konferenca u ofron studentëve një mundësi unike për t'u takuar me studentë nga universitetet e tjera dhe për të ndarë pikëpamjet e tyre për çështje domethënëse. Studentët gjithashtu inkurajohen të formulojnë mendime dhe të prezantojnë iniciativa të reja sfiduese. Kjo konferencë e fokusuar në sfidat më të cilat po përballen bizneset në epokën digjitale tenton të zgjerojë njohuritë e studentëve përmes artikujve të prezantuar dhe mikro diskutimeve.

NËN TEMAT

Prezantimet e konferencës studentore do të organizohen në 12 nën tema, që synojnë të mbulojnë çështje të gjera dhe të veçanta të sfidave të bizneseve në epokën digjitale. Nën temat e dhëna nuk kanë për qëllim të kufizojnë prezantimet, por shërbejnë për të treguar hapësirën e pritshme të diskutimeve. Studimet e rasteve të përvojave dixhitale aktuale në biznese të ndryshme, para dhe gjatë pandemisë do t'i kushtohet vëmendje e veçantë.

1. Marketingu ne mediat sociale;
2. Tregtia elektronike;
3. Inovacion dhe transformim digjital;
4. Strategjitë e markës;
5. Kreativitet;
6. Reklamimi në Internet;
7. Teknologjia e marketingut;
8. Përvoja e klientit;
9. Analiza dhe të dhëna;
10. Marketingu në internet;
11. Marketingu i përmbajtjes;
12. Marketingu me email;

DATA TË RËNDËSISHME

- | | |
|---|------------------------|
| ▪ Afati i fundit për dorëzimin e abstrakteve: | 18 maj 2021 |
| ▪ Njoftimi vetëm për pranimin e abstrakteve: | 20 maj 2021 |
| ▪ Afati për dorëshkrimet e plota: | 30 maj 2021 |
| ▪ Njoftimi për pranimin e punimit: | 04 qershor 2021 |
| ▪ Drafti i programit: | 06 qershor 2021 |
| ▪ Data e konferencës: | 09 qershor 2021 |



BORDI SHKENCOR DHE ORGANIZATIV

Kryetar: Prof. Asoc. Dr. Ledina Alolli

Anëtarë:

Universiteti Fan S. Noli, UNIKO

Prof. Asoc. Dr. Eleina Qirici | Dr. Benita Stavre | Prof. Asoc. Dr. Sonela Stillo |

Prof. Asoc. Dr. Esmeralda Shkira | Prof. Asoc. Dr. Mamica Nene | Prof. Asoc. Dr. Oriola Theodhori |

Dr. Landi Gushi | Dr. Marenglena Hoxhaj | Dr. Alma Zhilla | Dr. Denada Olli | Dr. Rafail Prodani

Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, CIT

PhD. Blendi Shima | PhD. Altin Kulli

Albanian University, AU

Dr. Gilberta Hadaj | Dr. Genti Cela

Koordinatorë të konferencës:

✓ Dr. Alma Zhilla, *Universiteti i Korcës* | Anisa Hykaj, Resilda Muça, *IETT Albania*

UDHËZIME PËR STUDENTËT

RREGULLA PËR SHKRIMIN E ABSTRAKTIT:

Titulli: Times New Roman 14 pikë, të gjitha me shkronja të mëdha (bold dhe justify);

Autorët: Emër, mbiemër, grada/titulli, Universiteti, Fakulteti, Vendi, adresa e-mail;
Time New Roman 11;

Abstrakti: Time New Roman 12; nuk duhet të ketë më shumë se 200 fjalë
(pa përfshirë titullin, dhe të dhënat e autorëve) ; Fjalët kyçe - Time New Roman 11, italic (3 - 5 fjalë);

- Abstrakti nuk duhet të përmbajë tabela dhe grafikë, citime;
- Abstrakti duhet të përmbajë çështjet dhe objektivat, duhet të tregohet metodologjia që do të përdoret, burimet dhe ku qëndron rëndësia e punimit.;
- Numri maksimal i abstrakteve që pranohen nga një autor (pavarësisht renditjes së tij) është vetëm një.
- Abstrakti do dorëzohet në dy gjuhë: shqip dhe anglisht
- Abstrakti dërgohet në adresën: **konferencastudentore@unkorce.edu.al**



TË DHËNA PËR ARTIKULLIN E PLOTË:

- **Hyrja:** Në hyrje duhet të prezantohet përmbajtja e punimit dhe qëllimi i tij. Gjithashtu madhësia e lejuar 1-3 faqe A4.
- **Pjesa kryesore: Çështjet.** Punimi mund të ndahet në disa çështje në varësi të temës së zgjedhur. Ato duhen të jenë në shërbim të temës dhe duhet të kenë lidhje me njëra-tjetrën.
- Gjatësia artikullit: Artikulli nuk duhet të jetë më i gjatë se **9 faqe, format A4**.
- **Cilësia e shkrimit:** Teksti duhet të shkruhet me hapësirë 1.15 ndërmjet rreshtave. Hapësira 1.15 do të përdoret edhe për përgatitjen e tabelave të gjata, të ekstrakteve, të shënimeve, të shpjegimeve të gjata dhe të listës së bibliografisë. Lloji i vetëm i shkrimit të përdorur duhet të jetë “Times New Roman”.
- **Madhësia e shkronjës** duhet të jetë 12-she.
- **Numrat e faqeve:** Të gjitha numrat e faqeve duhet të vendosen poshtë dhe në mes të faqes.
- **Tabelat:** Tabelat është mirë të përfshihen në tekst. Ato duhet të vendosen në qendër të faqes. Çdo tabelë i duhet vendosur një numër referimi me numër arab. Numri i tabelës duhet të ndjekë numrin e kapitullit të cilit i përket. Fjala “tabelë”, numri i tabelës dhe legjenda duhet të vendosen në krye të tabelës. Nëse tabela vazhdon në faqen tjetër legjenda nuk përsëritet. Nëse një tabelë përmban citate, referencat duhet të theksohen.
- **Diagramet:** Nëse diagramet paraqiten si fotografi, duhet të vendosen në faqen përkatëse, ilustrimet ose grafikët nuk e ndjekin tekstin ose tabelën gjithmonë. Fjala “figurë”, numri i diagramit me numër arab dhe shpjegimet duhet të vendosen poshtë diagramesh. Përgjithësisht një diagram nuk duhet të kalojë një faqe. Nëse diagrami vazhdon në faqen tjetër, duhet të ndiqet rregulli për tabelat. Si edhe tabelat, diagramet duhet të mblidhen bashkë dhe t’u vihen numra pasues. Fotografitë që janë më të vogla se një faqe duhet të vendosen në faqen përkatëse.
- **Përfundime:** Në pjesën e përfundimeve duhet të shkruhet rreth temës së zgjedhur dhe çfarë është arritur të provohet dhe cilët përfundime veçohen. Përfundimet i japin përgjigje problemeve të parashtruara në hyrje dhe të diskutuara në pjesën kryesore. Madhësia e lejuar deri në 1-3 faqe A4 • Punimi duhet të përmbajë referencat të mjaftueshme dhe të sakta të vendosura sipas rendit alfabetik , sipas stilit APA.
- Autorët artikullin e plotë e dërgojnë në adresën elektronike të konferencës:
konferencastudentore@unkorce.edu.al

KONTAKT:

Dr. Alma Zhilla | konferencastudentore@unkorce.edu.al

Resilda Muça | +355 67 605 80 44 | info@iETT.al